



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**Njoftim paraprak përqëndrimi
(Rasti TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)/Viena
Insurance Group/SIGMA sha)**

1. Në datën 20 Janar 2009 Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar se aksionerët e shoqërisë Sigma SHA, janë në negociata për realizimin e një marrëveshje, e cila u nënshkrua në 24 Mars 2009, me objekt shitblerjen e 87 % të kapitalit aksioner të kësaj shoqërie. Njoftimi i plotë i përqëndrimit, është depozituar në Autoritetin e Konkurrencës në datën 27 mars 2009.
2. Palët pjesëmarrëse në transaksion:
 - **TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)**, me seli në Amsterdam, Hollandë, në cilësinë e shitësit; dhe
 - **Vienna Insurance Group (VIG)**, me seli në Vienë, Austri, në cilësinë e blerësit, përfton kontrollin në mënyrë të drejtëpërdrejtë, nëpërmjet blerjes të aksioneve nga TBIH.
 - Shoqëria Sigma SHA, brenda të cilës ndodh transaksioni, është shoqëri e të drejtës shqiptare, me seli në adresën “Komuna e Parisit”, Pallatet “Lura”, Kati I, Tiranë.
3. Veprimtaria e palëve:
 - Për TBIH janë shërbimet në fushën e sigurimeve dhe të pensioneve. TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) ka shtrirje në Hollandë, Austri dhe ka blerë shoqëri sigurimesh në Gjergji, Rusi dhe Ukrainë. Aksionerët kryesorë të TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) janë Vienna Insurance Group që zotëron 60 % të aksioneve dhe Kardan Financial Services B.V me 40 për qind të aksioneve.
 - Për VIG është sigurimi i jetës, përfshirë sigurimet suplementare, të shëndetit etj, e licensuar nga Autoriteti Mbikqyrjes së Sigurimeve austriak. VIG operon në 23 vende të Europës qendrore dhe Lindore, si Republikat e ish Bashkimit Sovjetik, Bullgari, Kroaci, Çeki, Rumani, Serbi, Mal të Zi, Turqi etj. Vienna Insurance Group ka kontrolluar që

prej vitit 2007 në mënyrë të tërthortë nëpërmjet shoqërisë TBIH, veprimtarinë e ndërmarrjes Sigma SHA.

- Sigma SHA ushtron veprimtarinë në tregun e sigurimit të jetës dhe jo jetës. Sigma SHA ushtron veprimtari indirekt në tregun e pensioneve vullnetare, nëpërmjet kontrollit të 75% të kapitalit në ndërmarrjen Sigma IPP ShA. Objekti i aktivitetit të Sigma IPP SHA është mbledhja e kontributeve dhe shpërndarja e përfitimeve midis personave që marrin pjesë në Fondin privat të Pensioneve në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi
4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Autoriteti gjeti, që përqendrimi i njoftuar sjell ndryshim të strukturës së shoqërisë dhe për rrjedhojë ndryshime të formës së kontrollit dhe është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit.
 5. Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën perqendrime@caa.gov.al